

Minna Skafte Jensen

E-mail address:

Një rrëfenjë heroike: Skënderbeu i Marin Barletit midis krijimtarisë gojore dhe letërsisë

webmaster@miqesia.dk

Please, write in English

Në kujtim të Androkli Kostallarit



Minna Skafte Jensen (lindur më 1937) As. Profesoreshë e Greqishtes dhe Latinishtes, Universiteti i Kopenhagenit, 1969-93. Profesoreshë e Greqishtes dhe Latinishtes, Universiteti i Danimarkës Jugore, 1993-2003. Anëtare e Akademisë së Shkencave dhe Letrave Daneze, Norvegjeze e Belge. Fushat kryesore të kërkimit: Epika arkaike greke dhe teoria e formulimit-gojor; poezia latine e Rilindjes në Danimarkë.

Miqësia falenderon për lejimin e publikimit të artikullit.

[PDF-edition](#)

English edition: [A Heroic Tale: Marin Barleti's Scanderbeg between orality and literacy](#)

Danish edition: [En heltehistorie: Marin Barletis Skanderbeg mellem mundtlighed og skriftlighed](#)

Përmbajtja

[Libri i Barletit](#)

[Autori, i adresuari dhe heroji](#)

[Stili tregimtar](#)

[Baballarët e historisë](#)

[Biografia dhe pasqyrimi i figurës së princërve](#)

[Historia dhe Epika](#)

[Mjedisi shqiptar](#)

[Barbarizmi dhe civilizimi](#)

[Biografia heroike midis epikës dhe romanit](#)

Libri i Barletit

Përshtypjet e shqiptarit Marin Barleti për jetën e Skënderbeut, bashkëkombësit të tij të madh, u botuan në Romë më 1508 -1510. Titulli i veprës është »*De Vita Moribus Ac Rebus Praecipue Aduersus Turcas, Gestis, Georgii Castrioti, Clarissimi Epirotarum Principis, Qui Propter Celeberrima Facinora, Scanderbegus, Hoc Est, Alexander Magnus, Cognominatus Fuit, Libri Tredecim, Per Marinum Barletium Scodrensem Conscripti*« (Rreth jetës së Gjergj Kastriotit, Princit të shkëlqyer të Epirotëve, figurës dhe veprës së tij heroike, veçanërisht kundër Turqve. Për shkak të akteve të tij të famshme heroike ai u mbiquajt Skënderbe, që do të thotë Aleksandër i Madh. Trembëdhjetë Libra nga Marin Barleti i Shkodrës, titull me të vërtetë informativ! Tema e tij është një hero. Vepra e jetës së tij u krye në Epir, u drejtua kundër turqve dhe ishte e një niveli të kohëve antike.

Skënderbeu jetoi nga viti 1405 deri në vitin 1468. Biografi i tij, prifti Barlet, u lind mbase në vitin 1450 dhe vdiq në vitin 1520. Pas pushtimit përfundimtar të Shqipërisë nga turqit ai emigroi në Itali, ku duket se kaloi pjesën e mbetur të jetës në Venedik dhe Romë. Ai shkroi librin e tij të mrekullueshëm të shtrirë në kohë dhe hapësirë, e cila i shton një shije tragjike përshkrimin të fitoreve të lavdishme të Skënderbeut mbi turqit. Pavarësisht akteve heroike të pashoqe të heroit, Shqipëria tani shtrihet në gërmadha, për shkak të shkatërrimit të veprës së tij pasi ai vdiq [1](#).

Prologu krijon këtë kuadër të zymtë, por sapo autori fillon përshkrimin e heroit të tij, melankonia e pranishme bëhet e pakuptimtë përkundërt ngacmimit që shkakton guximi dhe aktet fitimtare heroike. Por pikënisja është trishtuese. Vetëm imagjinoni çfarë do të ndodhte nëse Aleksandri i Madh kthehej! Apo Pirro, i cili në kohën e tij luftoi aq madhërisht kundër romakëve! Ata zor se do të ishin në gjendje të njihnin vendin e tyre, por do të largoheshin përsëri plot përbuzje, sepse ai nuk ishte më një vend i lirisë si në kohën e tyre. Mjerimi i sotëm është aq dërrmues sa autori ka frikë se nuk do të jetë në gjendje të bindë lexuesit se Shqipëria ishte e lavdishme jo vetëm në antikitet, por edhe gjatë periudhës menjëherë pas tij. Liria mbretëroi fuqishëm, aty ku tani është përhapur skllavëria. Në ato kohë e gjithë bota shikonte nga Epiri me admirim, kurse tani e vetmja pyetje është nëse fati do të lodhet ndonjëherë së ndëshkuari këtë vend.

Vepra i kushtohet Donferrante Kastriotit, nipit të Skënderbeut, por edhe brezave të ardhshëm, dhe qëllimi i saj i dyfishtë është të ofrojë një thesar shembujsh moralë nga realiteti e të sigurojë për kombin shqiptar llojin e pavdekshmërisë që duhet gjetur në famë dhe trajtuar nga shkrimtarët. Kështu, skena tashmë është e pushtuar nga tre protagonistë: Barleti, Donferrante dhe Skënderbeu, respektivisht autori, i adresuari dhe heroit.

Bëhet njëfarë njesimi i autorit me heroit: Barleti ndien se ai ka rrezikuar në një betejë në të cilën duhet të mbrojë veprat e heroit të vet nga honi i harresës, nga të gjitha anët ai dëgjon veprat e Skënderbeut ta thërrasin. Dhe ai ka vendosur të mos lejojë që ngarkesa e punës dhe ndrojtja ta frenojnë së shkruari, sikurse Skënderbeu nuk u frenua së vepruari. Libri i tij është para së gjithash një akt mirënjohjeje ndaj vendit të tij, *patriae praecipua pietas*.

Autori, i adresuari dhe heroit

Barleti dhe tregimtari janë thujse një. »Uni« që përdoret vazhdimisht, duke spekuluar komentuar dhe moralizuar, është prifti nga Shkodra. Në pak raste ai i referohet përvojës

së tij, si për shembull kur kujton sesi turqit në njëfarë pike udhëhoqën një ushtri kundër Shkodrës me aq dhelpëri sa »ne i vumë re vetëm kur ata po rrinin në portat e qytetit«, Në më të shumtën e rasteve ai sillet si tregimtar objektiv që nuk përshkruan çfarë ka ndodhur brenda karaktereve të tij, por i bën ata të zbulojnë qëllimet e tyre me anë të fjalëve dhe veprave, ose i referohet asaj çka i është thënë atij. Vetëm në raste të rralla ai shndërrohet në rolin e tregimtarit »të gjithanshëm«, dhe kjo ndodh veçanërisht në situata dramatike, si ajo përpara betejës vendimtare midis Skënderbeut dhe sulltan Muratit kur ai informon lexuesin për atë që secili nga luftëtarët është duke menduar. Nuk ka asnjë dyshim se në anën e kujt është ai. Nga momenti në të cilin Skënderbeu krijon ushtrinë e vet ai e quan atë »nostri«, ushtarët tanë. Herë pas herë ai duket sikur i kishte marrë lexuesit e tij në një udhëtim të drejtuar nëpër ngjarje si për shembull kur trupat kryejnë një lëvizje veçanërisht me fat, ai mund të thërrasë se »ishte një panoramë e mrekullueshme«, apo kur përshkrimi i ndezur i një sulmi nate mbyllet me »por tani na lejoni të kthehemi në kamp së bashku me Moisiun«. Nganjëherë komentet e tij janë sarkastike: »ndoshta më shumë ishte e pranishme frika se rreziku«, ose ngadhënjimtare: »Në këtë mënyrë barbarët, të cilët kishin si qëllim kërkimin e presë, u bënë vetë preja.«

Ai gjithashtu komenton rolin e vet. Kështu, ai shpesh diskuton rendin të cilin duhet të ndjekë, ose nëse do t'i lejohej një shmangie nga tema. Në parathënie ai shfaqë veten që ka ndërmarrë një barrë të tillë dërmuese duke iu referuar faktit se asnjë njeri tjetër nuk dukej i gatshëm ta bënte këtë. Që kjo nuk është vetëm modestia e rreme që autorët e Rilindjes shprehin gjithmone del nga fakti se në gjysmë të veprës ai paraqet një parathënie të dytë, në të cilën vazhdon të zgjerojë metaforën e barrës. Ai krahason veten me një endacak i cili ka mbajtur teshat e veta deri në gjysmë të rrugës, por s'është i sigurt nëse do ia dalë edhe për gjysmën tjetër. Nga respekti për të dy, lexuesin dhe vetveten, ai premton të ndërrojë ngarkesën nga një dorë në tjetrën, duke e vendosur në qafë apo shpatulla, e nganjëherë edhe duke pushuar. Me pak fjalë, ai premton të ndryshojë tregimin e tij dhe gjithashtu lë pak hapësirë për diskutim. Në të dy parathëniet ai gjithashtu nënvizon dëshirën e tij personale për të shkruar [2](#).

Duke patur parasysh që vepra e Barletit i adresohet nipit të Skënderbeut, ky i fundit ka një rol çuditërisht të vogël për të luajtur krahasuar me atë që normalisht i kushtohet nga autorët në këtë periudhë të adresuarve të tyre. Ai nuk është objekt i një panegjiriku, dhe në parathënien e dytë ai as që përmendet. Sidoqoftë, që biografia i është adresuar atij gjatë të gjithë kohës, shprehet indirekt në fund, kur Skënderbeu është duke vdekur. Heroi thërret së bashku të gjithë princërit shqiptarë si dhe disa të tjerë, midis tyre edhe disa të dërguar nga Venediku, të cilët rastisën aty. Ai lë djalin e tij të vogël Gjon në përkujdesjen e tyre dhe pasi e tregon atë si pasardhësin e vet mban një fjalim në të cilin udhëzon të birin për detyrat e një monarku të mirë. Një lexim i qartë i këtij fjalimi tregon se këto nuk janë vetëm fjalët e Skënderbeut drejtuar djalit të tij, por gjithashtu të autorit drejtuar nipit të heroit. Një i adresuar tjetër, i cili gjithsesi është përmendur shpesh, është brezi i ardhshëm. Motivi i Barletit për të shkruar buron nga bindja e tij se ai ka një mesazh të rëndësishëm për brezat e ardhshëm. Është përgjegjësia e tij që veprat heroike të Skënderbeut dhe madhështia shqiptare nuk duhet të gëlltiten nga honi i harresës. *Edax oblivio*. Një pjesë vecanërisht e rëndësishme e kësaj audience formohet nga lexuesit venedikas. »Senati dhe populli venedikas« përmenden kudo me respektin më të madh, edhe kur Venediku tradhton Skënderbeun duke hyrë një një aleancë me turqit, dhe në skenën e ngarkuar ideologjikisht në shtratin e vdekjes së Skënderbeut, qyteti lavdërohet në detaje. Që Barleti gjithashtu shpresoi të gjente lexues në oborret e Romës e Napolit kuptohet nga lëvdatat që ai ngre mbi princërit e mëdhenj të vdekur si mbreti Alfonso i Napolit dhe Papat Piu i II (Eneas Silvius) dhe Pali i II. Barleti gjithsesi nuk i drejtohet një audience specifike. Lexuesit e tij potenciale janë të gjithë ata që mësojnë veprën e tij dhe autori drejton një dialog të lirshëm me ta, pyet veten nëse ata do ta besojnë dhe i siguron se vepra e tij përmban mësim të dobishme morale [3](#).

Heroi, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, është figura që bashkon gjithë krijimtarinë që bën fjalë për jetën e tij. Bëmat e tij ndahen në dy pjesë: Lufta kundër Amurathes (Murati i II, 1404-51) dhe Mahometes (Mehmeti i II, 1432-81), respektivisht librat 1-6 dhe 7-13. Skënderbeu është një shenjt, një fakt që edhe para lindjes së tij është bërë qartësisht i dukshëm me anë të ëndrrave dhe ogureve, (ndonëse autori nuk beson në to), vetëm sepse ai është, sigurisht djali më i vogël [4](#). Që fëmijë ai dhe vëllezërit e tij u morën peng nga sulltani turk, në oborrin e të cilit iu dha një arsimim i shkëlqyer në gjuhë, kalërim e përdorimin e armëve dhe ku tashme, si një djalë i ri ai e tregon veten të aftë t'i rezistojë urisë, etjes, nxehtësisë, dhimbjes e pagjumësisë. Ai bëhet i preferuari i të gjithëve dhe sulltani shpejt fillon t'i japë detyra të nderuara. Karriera e tij turke kulmon kur i besohet udhëheqja e një ushtrie kundër hungarezit Huniad. Skënderbeu, i cili kishte planifikuar prej kohësh të kthehej në vendin e tij, lejon ushtrinë turke të shpartallohet me qëllim që ai vetë me një shpurë të zgjedhurish të mund të kalëronte drejt Shqipërisë, ku me anë të një dredhie ushtarake pushton kalanë kryesore, Krujën. Ai mbledh princërit shqiptarë në Lezhë dhe ia del të krijojë një front të bashkuar kundër turqve. Këta të fundit dërgojnë ushtri njëra pas tjetrës në vend dhe Skënderbeu i shpartallon të gjitha duke shfrytëzuar mirë terrenin dhe ndërruar vazhdimisht taktikat. Ai arrin famën që meritonte si mbrojtës i Kristianizmit edhe përkrahet nga Republika e Venedikut, mbretërit Alfonso dhe Ferdinand i Napolit dhe Papët përkatës. Me vdekjen e tij ai u lë trashëgimtarëve një vend të lirë dhe të pavarur.

Në veprën e tij, Barleti, vazhdimisht thekson anën kombëtare. Keshtu, Skënderbeu nuk është vetëm një hero madhështor, por gjithashtu edhe shpëtimtar i atdheut të vet. Kur ai krahasohet me Aleksandrin e Madh dhe Pirron, këta nuk janë modele të zgjedhur në mënyrë arbitrare nga antikiteti, por heronj kombëtarë, Maqedonia e Aleksandrit dhe Epiri i Pirros janë për Barletin sinonime të vendit të tij. Kryesisht ai e quan atë Epir, por shpesh edhe Shqipëri. Duke dalë pak nga tema, në fillim të veprës ai sqaron pikëpamjen e tij mbi historinë e kombit, bazuar në historiografin romak Pompeius Trogus dhe bashkëkohësin e tij Papa Piu. Kështu shqiptarët fillimisht jetonin në Kolkis në Detin e Zi, nga ku ata sollën gjuhën e tyre. Ata fillimisht emigruan në kodrat Albani pranë Romës. Kur Herkuli, që një nga dymbëdhjetë detyrat e tij kishte të vriste Xheronin, po shtegtonte bagëtitë e këtij të fundit nga Spanja nëpër Itali, qëndroi për një kohë në kodrat Albani. Nga aty shqiptarët e ndoqën pas dhe tani ata jetojnë në Maqedoni dhe Peloponez.

Me këtë analizë të shkurtër Barleti i bashkohet një diskutimi bashkëkohor të përhapur gjerësisht në të cilin autorët orvaten të përshtatin kombet e tyre në historinë e përgjithshme ose të Biblës, ose të mitologjisë greko-romake. Për shembull, në shekullin e 16-të, kishte një konflikt të nxehtë midis Suedisë dhe Danimarkës mbi origjinën dhe historinë e hereshme të popujve të tyre. Me këtë teori Barleti ishte në gjendje t'i jepte kombit të tij një histori vetëm pak më të vjetër se ajo e Romës sikurse shfaqet nga "Eneida" e Virgjilit. Historia e Herkullit dhe Zheronit u zhvillua një brez përpara mbërritjes së Eneidës në Itali. Që në fillim të shtjellimit të temës del qartë se Barleti është i vetëdijshëm që ai është nismëtari në përshkrimin e figurës së Skënderbeut si dhe në paraqitjen e kombit të vet para Komunitetit [5](#).

Stili tregimtar

Plani i përgjithshëm i veprës është kronologjik, duke përshkruar aktet heroike të heroit vit pas viti, dhe kjo procedurë analistike historiografike është herë pas here e shoqëruar me shënime të tipit: »Ky ishte një vit i mirë për Skënderbeun dhe popullin e tij«. Disa nga librat kanë temat e tyre individuale. Për shembull, libri 5 bën fjalë për pushtimin turk e zaptimin e Sfetigradit dhe protagonist ka një nga oficerët e Skënderbeut, Moisiun, kurse në librin 8 mbizotëron përshkrimi sesi Moisiu tradhton heroin, dezerton në shërbimin turk,

shpartalohet nga Skënderbeu dhe më në fund kthehet pro tij. Libri 10 tregon historinë e ekspeditës së Skënderbeut në Itali dhe libri 11, për vdekjen e tij. Shumë përshkrime të betejave lëvizin midis pamjeve panoramike të ushtrisë dhe fokusit mbi aktet heroike të individëve, dhe në më shumë së një rast, duele të formalizuara zëvendësojnë betejat midis dy ushtrive. Tregimi luhet mes ndryshimeve të ritmit dhe pikëpamjeve. Kryesisht ai nuk ngutet, por ndonjëherë gjërat shpejtohen në mënyrë të konsiderueshme. Për shembull, në njëfarë pike ushtritë turke dhe shqiptare janë të vendosura në formacione kundërshtarë, kur Skënderbeu merr lajmet e afrimit të një ushtrie tjetër turke. Ai menjëherë, nisët me disa kalorës të zgjedhur, mësyn ushtrinë që afrohet, e mund atë, zë rob komandantin e saj dhe kthehet brenda natës në kampin e tij dhe e gjitha kjo e thënë në 8 rreshta. Në të njëjtën kohë e gjithë biografia është strukturuar me ndihmën e fijeve tregimtare që shfaqen gjatë veprës përmes periudhave të gjata të kohës duke lidhur Skënderbeun personalisht me protagonistët e tjerë. Kështu, ai kishte lidhje të ngushta me të dy sulltanët gjatë fëmijërisë së tij në Adrianopojë, me Muratin, si thjeshtër i tij dhe me Mehmetin, si vëlla dhe rival. Që fëmijë, Skënderbeu dhe Mehmeti provuan forcën e tyre duke përkulur një hark dhe Mehmeti ishte mundur nga Skënderbeu, por jo nga ndonjë djalë tjetër në oborr. Lidhja baba-djalë midis Skënderbeut dhe Muratit i jep një patos të vecantë pjesës së parë të veprës për shkak të përfshirjes së anës etike të problemit. Barleti sigurisht që nuk pyet seriozisht për të drejtat morale të vendimit të Skënderbeut për të lënë perandorinë turke e për të luftuar kundër saj, dhe ne gjithashtu na është thënë se pozita e tij në oborr ishte e dyshimtë dhe mbase sultani do ta hiqte qafe nëse ai do të rrinte. Sidoqoftë, mungesa e mirënjohjes së tij ndaj Muratit është një akuzë që mund të përdoret nga Turqit në fjalime dhe në këtë mënyrë ajo ekziston si një element shqetësues përgjatë gjithë gjysmës së parë të biografisë. Brenda ushtrisë së Skënderbeut është marrëdhënia e tij me Moisiun dhe gjithashtu një tjetër kërcënim, diçka më i zgjatur, që lidhet me tradhtinë e Hamzait. Ashtu si Moisiu, Hamzai ishte nipi i Skënderbeut dhe një nga oficerët e tij, por ai ishte ambicioz dhe nuk ndihej i vlerësuar sa duhet. Konflikti tregohet në fillim të veprës kur Skënderbeu, në një pikë të caktuar, e korrigjon atë në prani të ushtrisë së mbledhur, por vetëm në librin 9 tregimi zhvillohet plotësisht.

Kështu, drama e veprës është e bazuar së tepërmi në çështjen thelbësore të etikës personale. Çdo gjë zhvillohet sikur të ishte në një skenë me tregimtarin dhe lexuesin si vëzhgues të vëmendshëm dhe vlerësues. Barleti i paraqet qartë karakteret e tij duke i kundërvënë ndaj njëri-tjetrit në skena të gjalla. Si shembull ne mund të shikojmë në fillimin e librit 3, në të cilin revolta shqiptare ndaj turqve fillon të marrë formën e një konflikti personal midis Skënderbeut dhe sulltanit. Secili protagonist ka një pozicion të fortë duke filluar nga Murati, sepse ai sapo kishte shpartalluar një ushtri të madhe Kristiane në Varna, Hungari si dhe Skënderbeu, sepse ai kishte shpartalluar ushtrinë turke që sulltani kishte dërguar në Epir për t'i detyruar rebelët të ktheheshin andej nga kishin ardhur. Por sulltani është i vjetër dhe i lodhur dhe dëshiron të kalojë vitet e fundit të tij në paqe dhe qetësi. Për këtë arsye ai provon »truket e famshme dhe gënjeshtat e tij të cilat kishin qenë efektive kundër të tjerëve« dhe ai i dërgon Skënderbeut një letër në të cilën i flet si babai të birit, duke e akuzuar për mosmirënjohje, duke i numëruar të gjitha të mirat që i kishte bërë dhe duke i ofruar paqe me kushte jo shumë të favorshme. Skënderbeu i përgjigjet me një pjesë retorike klasike të shkëlqyer »Ushtari kristian, Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur Skënderbe, Princ i epirotëve, përshëndet Sulltanin Otoman Murat, Princin e turqve. Në rastet e mëparshme ju pretendoni se ma keni kaluar me të gjitha llojet e të mirave: sot unë do t'ju mund me një fjalim të disiplinuar dhe modest. Sipas meje, asgjë nuk është më e qartë se kaq, shenjë e një mendjeje të skllavëruar, si pazotësia për t'u shmangur nga gjuha vulgare dhe fjalimi i paturp, madje edhe në drejtim të armikut më kërcënues. Kështu, unë i mora dhe i pashë të dyja, letrën dhe të dërguarin tuaj me qetësi të madhe në mendje, dhe, për të qenë i vërtetë, letra juaj shkaktoi tek unë të qeshura më shumë se irritim, kur që në fillim të saj ju guxuat të tregoni mosmirënjohje të madhe dhe poshtërsi ndaj meje, vetëm për të vajtuar më pas në një mënyrë paksa më të butë humbjen e shpirtit tim, ndërsa ju vetë, pa

vënë re fatin tuaj të dëshpëruar, me etje bëtë gabimin tuaj të përsëritur. Pa marrë parasysh të drejtat e luftës dhe ligjin e natyrës më propozuat në mënyrë jo të zgjuar, për të mos thënë brutale, shumë kushte për një lloj paqeje që veshët zor se durojnë ta dëgjojnë, sikur ju të ishit fitimtari dhe unë i humburi. Murati im i dashur, edhe pse fjalët tuaja mund të provokojnë shumë të liga dhe durimin më të madh të njeriut ndaj një fjalimi të lig, une i kuptoj ato si një shprehje pjesërisht e moshës dhe mendimeve të çoroditura të një plaku, pjesërisht nga hidhërimi. Kjo është kaq e thjeshtë për mua, sepse vetë kam vendosur të luftoj kundër jush, jo me sharje dhe zënka, por me armë dhe zemëratën e vetëm të një lufte.« Skënderbeu më pas mohon se sulltani i ka dhënë përfitime, dhe numëron në vend të tyre të këqijat që ai i ka bërë atij duke e privuar nga vendlindja, duke vrarë vëllezërit e tij edhe madje duke planifikuar ta heqë qafe vetë atë. »Akoma (*quousque tandem!*) prisni nga unë që të duroj me qetësi një padron kaq arrogant? ... Ju lutem, ruajini për të ardhmen shigjetat tuaja të mprehta të kërcënimit dhe mos vazhdoni të na sillni si shembull fatin e hungarezëve. Gjithkush, zoti im, ka natyrën dhe talentet e veta dhe na duhet të pranojmë me durim fatin e dhënë nga zotat. Ne gjithsesi nuk do të kërkojmë këshillë nga një armik rreth asaj se çfarë duhet bërë, as t'ju kërkojmë juve paqe, por zotave fitore. Pranoni përsëritjet tona. « Dorëzuar në kampin tonë, një ditë përpara *idus sextiles 1444*«.

Letra, jo vetëm që e xhindosi, por edhe e shqetësoi sulltanin. »Me qëllim që të mos i zbulonte njerëzve të tij ndonjë gjurmë hezitimi, thuhet se ai lehtësoi mjekrën e tij të vjetër dhe u shtir sikur qeshte ndërsa tha: 'kështu po kërkon një emër të lavdishëm në vdekje, ti tradhtar, ja pra se çfarë je ti. Do të ta japim atë, do të ta japim, mund të jesh i sigurt; do të marrim pjesë në varrimin e birit tonë të adoptuar dhe si miq të paftuar do të ndjekim varrimin e tij, ti mbret i madh i shqiptarëve, kështu që në Ferr nuk do të të duhet kurrë të vajtosh që gjete një vdekje të poshtëruar'« [6](#).

Kontrasti midis Skënderbeut krenar, të stërvitur në mënyrë klasike dhe Muratit të vjetër të vrullshëm vazhdon në pjesën e parë të biografisë. Konflikti arrin kulmin në librin 6, kur së bashku me të birin, vetë sulltani personalisht udhëheq një ushtri në Epir dhe pushton Krujën. Këtu Murati vdes, pasi ka transferuar kurorën në mënyrë solemne tek Mehmeti. Në fjalimin e tij në shtratin e vdekjes ai thekson sesi pavarësisht gjithë fitoreve të tij, ai akoma nuk e ka gjuhëzuar Epirin. Për këtë arsye vdekja e tij ka një grimë tragjedi e fjalimi, sigurisht, në të njëjtën kohë është edhe një lëndatë e fortë indirekte për Skënderbeun dhe shqiptarët. Motivi Murati përballë Skënderbeut nuk shpreh vetëm moshën përballë rinisë, vrullin përballë disiplinës, por para së gjithash forcën e një kombi jashtëzakonisht superior përballë qëndresës së një populli të vogël të paepur.

Baballarët e historisë

Pjesa më e madhe e tematikës së Barletit mund të krahasohet me atë të historianit të parë antik, Herodotit, vepra e të cilit i ka qëndruar kohës. Të dy, ai dhe Barleti përshkruajnë sesi një fuqi inferiore shpartallon një fuqi superiore dhe të dy i kuptojnë ngjarjet si një betejë për liri. Që e para mundi të dytën ndodhi kryesisht për faktin se fuqia më e vogël luftonte për një qëllim më të madh. Por ndërsa vepra e Herodotit është plot me eufori, se grekët mundën persianët, pikënisja e Barletit është një melankoli e dukshme që hedh një hije të thellë edhe mbi pasazhet e treguara më energjikisht. Në të dy rastet fuqia superiore është një perandori orientale despotike dhe tregimi zhvendoset prapa midis heronjve tanë dhe despotit. Barleti e quan sulltanin *tiran*. Përveç kësaj, edhe pse të dy autorët janë kryesisht të përqëndruar në lëndimin e akteve heroike të fitoreve, ata nuk janë të pandjeshëm për patosin e fateve të të humburve.

Ka gjithashtu ngjashmëri në rrethanat në të cilat shkruajtën të dy historianët. Secili prej tyre ishte i pari që dha një përshtypje të shkruar të ngjarjeve të paharrueshme që ndodhën

në të kaluarën e tyre të afërt dhe burimet e tyre ishin kryesisht gojore. Herodoti, herë pas here i referohet burimeve të shkruara, kryesisht në përshkrimet e tij të gjata jashtë teme për Egjiptin. Barleti fillimisht pohon se nuk ka patur në dispozicionin as kronika, as tregime historike. Më vonë, në veprën e tij ai e zbut pak këtë pohim dhe thotë se për një ngjarje të caktuar ai »zor se ka patur ndonjë burim të shkruar«, dhe herë pas here futet në një polemikë kundër autorëve të tjerë pa emër. F. Pall ka treguar se Barleti tërhiqet nga historianë humanistë italianë në trajtimin e çështjeve joshqiptare. Por për temën e tij kryesore, Skënderbeun dhe veprat e tij, ai mbase po krijon vetëm mbi çfarë i është thënë. Si hyrje, në përshkrimet e tij të arritjeve të Skënderbeut si aleat i mbretit Ferdinand të Napolit kundër Zhosë së Azhuinëve, ai ankohet se në shumë legjenda rreth kësaj lufte nuk kish mundur të gjente një fjalë të vetme rreth heroit të tij dhe e konsideron këtë një akt mosmirënjohje nga ana e historianëve napolitanë [7](#).

Herodoti dhe Barleti gjithashtu ngjajnë me njëri-tjetrin në mënyrën sesi i trajtojnë burimet e tyre. Ata pwrpiqen tw krijojnë një pamje sa me të qëndrueshme mbi informacionin që mund të kenë, dhe nëse detajet duken të çuditshme apo kundërshtojnë njëra-tjetrën, ata citojnë pikëpamje të ndryshme mbi çështjen dhe vendosin çfarë u duket më e mundshme mbi bazat e një mendimi praktik. Për shembull, Barleti shkruan: »Këtu një lexues i interesuar mund të pyesë: kush ishte qëllimi dhe përparësia e vendimit që mori Kastrioti, vetëm për t'u zmprapsur përpara armikut kur ai pothuajse e ndjeu para hundës së tij, dhe të tërhiqej më mirë drejt Lezhës se drejt drejttimeve të tjera? Por unë nuk hezitoj të jap shpjegimin që mendoj se mund të jetë sa më i besueshëm për njerëzit e tjerë, që ata, kujdesin dhe ndershmërinë e të cilëve kam patur parasysh gjatë krijimit të të gjithë kësaj vepre dhe të cilët i kam ndjekur me vullnet, të mos devijojnë nga mendimi im.« Në raste të veçanta ata mund të largojnë veten e tyre nga një burim, sikundër Barleti me ironi përmend se ajo çfarë heroit i tij në këtë rast rrezikoi "mundet ndoshta më tepër të thërrasë më përpara admirimin e brezave të ardhshëm sesa besimin". As Herodoti as Barleti nuk ishin dëshmitarë okularë të ngjarjeve të përshkruara, por midis informatorëve ata kishin njerëz të tillë. Ata të dy përdorën dy nivele të të kaluarës, të kaluarën e afërt, e cila është tema e tyre, dhe të kaluarën e largët. Për Barletin, kjo e kaluar e largët është lulëzimi i Maqedonisë dhe Epirit në vitet 300 para erës së re e njohur nga letërsia klasike dhe për Herodotin është lufta e Trojës dhe ngjarje të tjera mistike të përshkruara në poemat epike. Për të dy mund të thuhet se ata qëndrojnë në kufirin midis krijimtarisë gojore dhe letërsisë [8](#).

Sidoqoftë ka diferenca thelbësore në atë çka bënin ata. Herodoti jetoi në një kulturë që ishte kryesisht gojore, ndërsa Barleti fizikisht dhe gjeografikisht lëvizi nga një shoqëri fisnore analfabete drejt qytetit-kulture më të zhvilluar e të arsimuar të kohëve. Për nga arsimimi, Herodoti ishte thjesht një analfabet, një mjet transferimi i gjuhës së tij të folur në papirus. (Që kjo nuk ishte kaq e thjeshtë sa mund të duket është një çështje tjetër dhe jo tema ime këtu.) Shkrimi e këndimi latin i Barletit pati pas një traditë pothuajse të dy mijëvjeçarëve, të pasur me modele përkatëse të shpërndarë mbi një spektër të tërë të gjinive, secili me karakteristikat e rënjosura nga koha. Herodoti krijoi për bashkëqytetarët e tij grekë, ndërsa Barleti shkroi rreth patriotëve të tij për një rreth lexuesish të huaj. Më thjeshtë mund të thuhet se Herodoti jetoi në një qendër kulturore të ditëve të tij dhe pati gjuhën e saj si një gjuhë të përditshme, ndërsa Barleti erdhi nga një periferi dhe u përpoq të depërtonte në kulturën qëndrore duke përdorur formën e saj normale të komunikimit. Mbase ai nuk shkroi në gjuhën e tij shqip. Ai ishte arsimuar në një enklavë të vogël mësimi, në Shkodër, mbase nga franceskanët italiane, dhe për të gjuha e shkruar mund të ketë qenë ekskluzivisht latinisht; kjo mbase ishte gjuha e tij e huaj më e rëndësishme dhe e vetmja e folur. Do të ishte e vështirë për të të shkruante në shqip, ndërsa në shkrimin e latinishtes ishte ushtruar që kur ishte fëmijë. Dhe kush do ta kishte lexuar atë nëse ai do të shkruante në gjuhën e vet? Vetëm një pakicë e vogël e popullsisë shqiptare kishte mësuar të lexonte, dhe në çdo rast do të kishte qenë në latinisht ose greqisht.

Teksti më i hershëm i shkruar në shqip që njihet sot është një ritual pagëzimi nga viti 1462, i cili në asnjë mënyrë nuk përuroi një letërsi të shkruar në shqip. Nga shekujt që vijuan u shpwtuan vetëm tekste të veçuara, kryesisht ato për përdorim fetar. Letërsia e shkruar shqipe, me shumicë fillon në shekullin e 19-të, dhe një publik i gjerë lexuesish u krijua pas Luftës së Dytë Botërore me zhdukjen e analfabetizmit nga autoritetet socialiste. Për Barletin, e vetmja zgjedhje natyrale gjuhësore duhet të ketë qenë latinishtja, dhe në zgjedhjen e latinishtes ai zgjodhi jo vetëm një gjuhë dhe një alfabet, por edhe një mënyrë të menduari.

Biografia dhe pasqyrimi i figurës së princërve

Barleti e kupton epokën e tij në kuadrin e antikitetit greko-romak dhe kjo duket qartë në faqen e parë kur ai i referohet Aleksandrit të Madh. Këtu ai është në harmoni të plotë me stilin latin të kohës. Letërsia e Rilindjes, e shekullit të 15-të dhe 16-të, i ofroi Barletit një zgjedhje midis një numri formash letrare që ishin të gjitha zhvillime të mëtejshme të formave antike romake. Tema e tij, heroi i madh dhe bëmat e tij legjendare do t'i shkonin për shtat epikës dhe qëllimi i tij caktuar për të siguruar lavdinë e heroit për brezat ishte gjithashtu qartësisht temë për një epikë. Mundësi të tjera ishin historia ose biografia, dhe mbase letra ose ligjërata. Më parë ai pati krijuar një vepër historike, një përshkrim të rrethimit dhe rënies së Shkodrës nga turqit, e shtypur në Venedik më 1504. Kur vendosi të krijonte një biografi, ai zgjodhi një formë të lartë moderne. Interesi i Rilindjes për individin i kishte dhënë biografisë popullaritet të padëgjuar, dhe kjo u shoqërua me paraqitjen e autobiografisë si një gjini letërsisë. Duke pasqyruar këtë model, biografite krahasuese të fisnikëve grekë dhe romakë u përkthyen nga greqishtja në latinisht, ndërsa legjendat e shenjtorëve të mesjetës humbnin tërheqjen e tyre popullore. Kur prifti Barlet formoi portretin e tij të aleatit të Papës, protagonistit të kristianizmit kundër muslimaneve, ai zgjodhi një version puro pagan të gjinise dhe paraqiti heroin e tij si një komandant të madh nga antikiteti klasik të kthyer në jetë, ndërsa Bibla nuk merrej fare parasysh si një kuadër i mundshëm referimi. Në raste të rralla ai i thërret ndërgjegjes he reveals scruples. Për shembull, në mes të përshkrimit sesi Skënderbeu i ri iku nga përpjekjet e dyshimta të sulltanit në jetën e tij, ai shkruan: »por pse jam kaq naiv që të spekulloj në tym mbi planet e pasuksesshme të Muratit për hakmarrje dhe këshilla të trasha, sikurse dhe për masat e zgjuara që mori Skënderbeu kundër tij, në vend që thjesht t'ia atribuoj shpëtimin e tij Zotit?« Gjithsesi, pas disa shënimeve fetare sesi Zoti në të njëjtën kohë mbrojtë heroin nga sulltani dhe bëri që hungarezët të fillonin një luftë kundër turqve tamam në këtë kohë, duke i dhënë kështu Skënderbeut një shans për t'u kthyer në shtëpi, Barleti shpejt kthehet në mënyrën e tij racionale klasike të të menduarit [9](#).

Biografia e princërve ekzistonte si një formë letërsie në dy tipe kryesoret ku heroi mund të jetë përfaqësuar si luftëtar i madh ose si sundimtari filozofik. Skënderbeu menjëherë u zgjodh si modeli i luftëtarit, por Barleti me kujdes e plotësoi portretin e tij me elementë nga modeli i filozofit: Skënderbeu ishte i mirëarsimuar, meqë në oborrin e sulltanit atij i ishin mësuar gjuhët dhe letërsia turke, arabe, greke, italiane dhe ilire e më vonë kishte zgjeruar këtë arsimim me studime të historianëve antikë grekë e latinë, i frymëzuar nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjëlli [10](#).

Autori vlerëson mençurinë, kurajën dhe forcën e tij, si drejtpërdrejt në komente edhe në mënyrë të tërthortë nëpërmjet mënyrave në të cilat janë përshkruar veprat e tij fantastiko - heroike dhe reagimet ndaj tyre nga ata që e rrethonin. Shumë rëndësi i është dhënë mençurisë politike me të cilën ai trajtoi si të barabartët ashtu edhe vartësit. Për shembull, Skënderbeu ishte i kujdesshëm për të mos fyer princërit e tjerë dhe kështu nuk e mblodhi në Krujë kuvendin vendimtar, por në Lezhë, e cila ndodhej nën qeverisjen e Venedikut. Këtu asnjë nuk mund të ndihej më lart apo më poshtë se të tjerët. Edhe për sa i përket

ushtarëve të tij, ai vazhdimisht kishte si qëllim t'i stërviste sa më mirë ata dhe të mbante lart shpirtin e tyre të vazhdueshëm luftarak, dhe nënvizohet se ai zakonisht dëgjonte mendimet e tyre mbi të gjitha çështjet e rëndësishme. Ai vetë ishte gjithmonë në rresht të parë dhe ndante të gjitha punët e vështira me ushtarët e tij. Lajmëtarët, miqësorë ose jo, trajtoheshin në mënyrë të shkëlqyer, dhe Skënderbeu gjithashtu dinte si të shkëmbente dhurata me princërit e huaj në mënyrë të atillë që ishte e përshtatshme për të dy si për dhënësin ashtu edhe për marrësin, ose ai mund të provokonte një zyrtar turk në mënyrë të përkryer duke i dhuruar atij një plor, një drapër apo vegla të tjera bujqësore duke treguar me këtë se ai nuk i përkiste një familjeje fisnikësh apo diçkaje të tillë, por një kundërshtari të denjë. Skënderbeu është portretizuar me një numër të madh karakteristikash pozitive: ai ishte i butë, miqësor dhe fatlum, zotëronte virtyte, pjekuri, durim, forcë fizike dhe energji mendore të vërtetë, ai ishte një komandant i kujdesshëm e me eksperiencë dhe shfaqte një shenjtëri më tepër se një butësi njerëzore. Koncepte të ngjashme nga e njëjta periudhë dhe i njëjti mjedis janë nxjerrë në pah nga Marian Pade në diskutimin e saj të hyrjes së mbretit Alfons në Napoli në vitin 1453 siç përshkruhet nga Antonio Panormita: Kortezi paraqiste një numër figurash femërore që personifikonin karakteristikat e sundimtarit: fortuna (fat), spes (shpresë), fides (besim), charis (hijeshi), fortitudo (kurajë), temperantia (vetëkontrollit), prudentia (maturi), justitia (drejtësi) dhe clementia (mëshirë). Ajo çka Alfonso po demonstronte, në tërë kuptimin e fjalës, ishte e njëjtë me atë për të cilën vlerësohej Skënderbeu. Për Barletin mund të thuhet, siç tha Burkhard për një biograf tjetër të kësaj kohe: »...era e shekullit fryn përmes faqeve të tij« [11](#).

Paraqitja e Skënderbeut nga Barleti, ka megjithatë më shumë nuanca sesa ajo çfarë do të sugjeronte përnjëherë një listë e tillë konceptesh. Në një situatë ku heroi i lë ushtarët e vet të vrasin pushtuesit turq, por nuk do të riskojë reputacionin e vet për mëshirë, thuhet: "ai nuk e pranoi hapur mizorinë e tyre, por as nuk e përjashtoi atë". Në një kontekst tjetër, kur ai i kishte marrë të burgosurit shqiptarë të luftës dhe i trajtoi mirë ata, fillimisht, u vlerësua si besimtar dhe bujar, por më pas autori gjykon se mos ndoshta kjo ishte vetëm një taktikë, sa kohë që mëshira e tij mundësoi Skënderbeun të arrinte atë çfarë ai nuk kishte qenë në gjendje të arrinte me mjete ushtarake. Tregimtari është drejtpërsëdrejti kritik i protagonistit të tij kur në librat 3-4 ai e përfshin veten në një luftë kundër Venedikut. Libri 4 paraqitet si vijon: "ndërsa rebelimet, më tepër se një luftë, po zhvilloheshin midis kristianëve dhe Skënderbeu po plakej përpara mureve të Denim, Murati kishte të gjithë interesimin...". Në këtë rast është i qartë mendimi i tregimtarit se heroi duhet të ishte përqëndruar mbi turqit më tepër se mbi armiqtë kristianë. Menjëherë më pas Skënderbeu u krahasua me Hamzain, meqë ai tani kishte bërë gabimin që kishte qortuar tek nipi i tij. Kur Skënderbeu rrethon Danjën dhe më kot përpiqet ta pushtojë atë, shfaqet simpatia e tregimtarit për shqiptarët e thjeshtë në qytetin e rrethuar, të cilët vlerësohen për kurajën dhe këmbënguljen e tyre kundër Skënderbeut ndryshe të pathyeshëm. Realisht, nëse krahasohet me panegjirikët bashkëkohore në përgjithësi në të cilat cdo princ është një August i ri dhe cdo poet një Homer apo Virgjil i ri, kuadri i Barletit për heroin e tij është çuditërisht i rezervuar dhe i lëkundur: Skënderbeu është madhështor, por jo i pagabueshëm [12](#).

Autori, në mënyrë të përsëritur, nënvizon se konkluzioni moral është njëri nga qëllimet e tij: Arritjet e Skënderbeut nuk janë vetëm me vlerë për t'u kujtuar, por edhe për të mësuar prej tyre. Në këtë kuptim vepra e tij është e lidhur ngushtësisht me një tjetër formë të mirënjohur të letërsisë në Rilindje, pasqyrimin e princërve, në të cilën humanistët mësojnë sundimtarët sesi ata duhet të ushtrojnë pushtetin e tyre. Ky aspekt është veçanërisht i fortë drejt fundit kur Skënderbeu i flet te birit. Por Barleti gjithashtu ngre një polemikë kundër atyre të cilët i japin këshilla morale sundimtarëve ndërsa lë ngjarje të rëndësishme historike pa përshkruar, meqë mësimi më i mirë është ai që rrjedh nga studimi i modeleve të vërteta.

Sa i vërtetë ishte përshkrimi i Barletit gjykuar nga standartet moderne? Unë nuk jam zgjedhur për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, por që gjinia biografike si e tillë nuk ishte domosdoshmërisht shumë e përpiktë rreth asaj që mund ta quajmë saktësi historike është ilustruar kohët e fundit nga Martin Redher. Më 1520 Makiaveli krijoi një biografi të një princi Kastruço Kastrakani (Castruccio Castracani) nga Lukka, bazuar në një përshkrim tjetër të shkruar 25 vite më parë, i cili ishte ruajtur. Redher është kështu në një pozicion që të vëzhgojë procedurën e Makiavelit drejtpërsëdrejti dhe të dokumentojë sesi ai i jep panegjirikut të tij dhe qëllimit didaktik prioritet absolut përkundrejt gjykimeve të saktësisë historike. Midis të tjerave, Makiaveli pohon se heroi i tij vdes i pamartuar dhe pa pasardhës, megjithëse burimi i tij thotë qartë se burri i Lukkas, është baba i lumtur i 11 fëmijëve! Sa për Barletin, edhe një johistorian vë re se marrëdhëniet familjare midis Skënderbeut dhe dy sulltanëve turq janë në konflikt me moshën e personave të përfshirë, me përjashtim të asaj se përshkrimi i tij duket të ketë kaluar mbikqyrjen e historianëve relativisht të pasfidueshëm. Në fund të fundit, paraqitja e Barletit është thelbësisht çfarë është gjetur kur Skënderbeu është kërkuar në librat e zakonshëm. Kjo konfirmon përfundimin e P. Bartl që pavarësisht nga gabimet e kronologjisë, Barleti është akoma baza e çdo studimi për Skënderbeun [13](#).

Historia dhe Epika

Gjatë Rilindjes diskutohej gjithmonë nëse biografite ishin histori. Diskutimi nuk ishte rreth historiografisë përballë letërsisë artistike, por rreth stilit. Që në kohët e lashta historiografia gjykohej një detyrë retorike, një ideal i pa realizuar fare nga Livi. Një historian krijon në mënyrë koherente dhe nuk lejon që citimet ose referencat të ndërpresin tregimtarin. Ai i bën njerëzit e përfshirë të thonë mendimet e tyre në formën e ligjëratave. Në këtë mënyrë autori dramatizon veprën e tij: lexuesit i ofrohet mundësia e gjykimit të pikëpamjeve të secilës palë nga brenda, në përmbajtje, të themi. Teknika ishte prezantuar paraqitur nga Herodoti dhe pajisur me një arsytim nga Thusiditi, dhe kështu krijoi vetveten si një element i rregullt në historiografinë e lashtë. Sipas teorive të Rilindjes për format e letërsisë, biografite ishin krijuar në këtë mënyrë se konsideroheshin pjesë e historiografisë, por u jepej një formë më afër Suetonit nëse shiheshin si një gjini e veçantë [14](#).

Pikëpamja e Barletit në këtë diskutim është e qartë. Ai pëlqen të bashkojë së bashku ligjëratat dhe letrat dhe e bën këtë me mjeshtëri. Këto dy nëngjini së bashku lulëzonin si gjini të pavaruara, në forma të ndryshme. Me interes të vecantë në këtë kuptim është fakti se letrat artistike nga për sundimtarët orientalë, si sulltanët, ishin zakonisht si zbavitje popullore. Barleti i qëndron besnik ekskluzivisht modeleve antike dhe letrat turke të tij dukshëm, në asnjë mënyrë nuk përfitojnë nga një potencial ekzotik. Një incident i zakonshëm përpara çdo beteje është se komandantët u bëjnë thirrje ushtarëve të tyre, dhe mesazhi ideologjik i veprës nuk është shprehur vetëm në këto ligjërata; përsëri dhe përsëri edhe Skënderbeu dhe më shumë komandantë të thjeshtë shqiptarë theksojnë rëndësinë e luftës për liri, dhe në disa raste edhe turqit veprojnë kështu. Ligjëratat janë retorikisht elegante dhe rregullisht i referohen shembujve nga letërsia antike, pikësëpari nga Livi. Këtu lexuesit nuk i lejohet ndonje kritikë apo rezervë ironike; supozohet që ne të pranojmë pa rezerva se ushtarët e Skënderbeut ishin në gjendje të vlerësonin krahasimet rreth Marcellus, Torquatus apo Corvinus. Meqë arsimimi klasik i Skënderbeut është përshkruar, lexuesi nuk cuditet nga aftësitë e tij si një gojëtar latin. E njëjta logjikë e brendshme vihet re në vepër në lidhje me Pal Perlatin, komandant i Sfetigradit, i cili mban një ligjëratë të mbushur me shembuj klasikë. Pak më vonë, kur Sfetigradi ra dhe Perlati lë tregimin, thuhet për të se ai ishte një njeri i arsimuar mirë në mënyrë jo të zakonshme. Në anën tjetër Skënderbeu zbavitet nga një fjalim elegant i bërë nga një barbar turk. Tregimtari vetë gjithashtu përdor shumë shembuj antikë në dialogun e tij me lexuesin, për shembull që Skënderbeu është aq pijetar i sprovuar si Papirius Cursor, një takticien po aq dinak sa

Fabius Cunctator, etj. Normalisht Barleti nuk përmend autorët e cituar, por vetëm figurat që ai zgjedh t'i marrë si shembuj, dhe relativisht ka pak citime direkte. Vepra e tij nuk është e mbingarkuar me aluzione antike; stili është i më tepër i ushtruar se i mësuar. Krahasimet u japin jetë karaktereve në tekstin e Barletit dhe ai i vendos ato brenda një kuadri antik; tregimtari siguron se lexuesi ndihet rehat dhe kupton se temat e trajtuara janë të të të njëjtit nivel më cfarë mund të lexohet në letërsinë klasike [15](#).

Barleti mbase mori nga të dy, biografinë latine të Aleksandrit të Madh nga Quintus Curtius dhe biografitë greke të Arianus dhe Plutarkut, të cilat ishin përkthyer në latinisht nga humanistët në oborrin napolitan, ku gjithashtu edhe modeli kryesor i Barletit, Livi, ka qenë një fokus i interesimit të humanistëve. Barleti ka shumë afri me Livin. Të dy shkrimtarët janë tërhequr duke punuar me historinë, sepse ata i gjejnë epokat e tyre të mërzitshme dhe në të njëjtën kohë ata ndajnë një kënaqësi elementare në tregimtari si një kundërpeshë ndaj pesimizmit të tyre fundamental. Karakteret e Barletit mendojnë, flasin dhe veprojnë tamam si romakët e Livit. Francesco Pall bile ka demonstruar se pasazhe të gjata tek Barleti janë marrë direkt nga Livi duke ndryshuar vetëm emrat e personave dhe vendeve. Barleti gjithashtu është livist në çështjet e moralit; heronjtë e tij janë kryesisht ata që pa hezitim sakrifikojnë veten e tyre për një qëllim, dhe armiku i admiruar i romakëve, Hanibali, ka ndikuar dukshëm Skënderbeun e Barletit. [16](#).

Gjithashtu epika antike, kryesisht Homeri dhe Virgjili, janë modele të dukshëm. Struktura e veprës së Barletit imiton the *Eneidën*: libri i 12-të është veçanërisht një shtojcë midis librave 6 dhe 7 duke e ndarë veprën në dy pjesë. Në shekullin e 15-të, Mafeo Vegjo, kishte shtuar një libër të 13-të të *Eneidës*, në të cilin jeta e heroit vazhdon deri në vdekjen e tij dhe në mënyrë të ngjashme Barleti ka rezervuar një libër të 13-të për përshkrimin e vdekjes së Skënderbeut. Biografia e tij heroike është krijuar me përbërës të epikës antike, skena beteje, vlera individuale, rrethime, duele, sulme nate, porosira, festime, funerale dhe konkurse, bile edhe një katalog. Ai dashuron veprat heroike për hir të tyre dhe i vjen keq për zbulimin e barutit dhe gjyles, sepse ajo do të ndryshojë esencën e luftës, kështu që kuraja individuale dhe forca nuk do të kenë më rëndësinë që kishin deri tani. Aty këtu ai i referohet direkt Homerit, shpesh të quajtur thjesht »poeti«, siç ishte e zakonshme në kohët antike. Për shembull, thuhet për një nga turqit se ai i ngjante Tideut të Homerit, duke qenë i vogël dhe i gjerë, por një luftëtar i madh. Homerit i referohet kryesisht në pjesën e dytë të veprës së tij dhe modeli është *Iliada*, rrallë ndonjëherë *Odisea*. Vec kesaj, nga Barleti janë imituar edhe disa aspekte të stilit të Homerit, veçanërisht krahasimet, por ai nuk i përdor fare përsëritjet karakteristike homerike.

Epika e Lukan, *Farsalia* është futur në tregim në një pjesë qëndrore pa u përmendur hollësisht nga Barleti. Në librin e 9-të, në të cilin Hamzai lufton në krahun turk, beteja vendimtare zhvillohet në fushën Aemathia. Përshkruhet sesi komandanti turk udhëheq ushtrinë e tij herët në mëngjes përpara se dita të zbardhë. Bari është i njomë me vesë, sikurse është njëherë i njomur me gjakun romak. Duket sikur fusha ka etje për gjak të ri e jepen shenjat ogurzeza që paralajmërojnë një katastrofë të pashmangshme: për shembull një nga mbajtëset e flamurit bie në tokë, e tërhequr nga pesha e flamurit, dhe disa njerëz madje pohojnë se po binte shi gjaku dhe se tufa të mëdha qyqesh ishin mbledhur. Këto detaje janë të gjitha aluzione me *Farsalian*. Këtu gjithashtu, është një shenjë ogurzezë kur flamujt bëhen të rëndë dhe qyqet e Barletit mbërrijnë direkt nga gostia mbi trupat tek Lukani pas betejës së Farsalisë. Poeti romak bën një përshkrim të tillë të fushës së etur për gjak, dhe pas betejës është njollosur për gjithmonë, gruri i mbjellë atje rritet i çngjyrosur nga gjaku, dhe përjetësisht parmenda do të ndeshë në kocka romake. Fushat e Thesalisë do të shohin ushtri të reja, madje edhe para se gjaku nga beteja e Farsalisë, të jetë tharë, ata do t'ia ofrojnë vetes së tyre një skenë për një krim të ri. Tek Lukani pasazhi është një profeci e betejës së Filipit, por me këtë aluzion Barleti e paraqet betejën midis turqve dhe shqiptarëve si një përmbushje të mëtejshme të profecisë së Lukanit. Zhvillimi i

kësaj beteje ekzaktësisht aty ku u zhvilluan dy betejat më të famshme të luftërave civile romake i jep ndeshjes midis Skënderbeut dhe Hamzait një ndjenjë fataliteti dhe Barleti nuk i reziston tundimit për një shmangie të vogël nga koncepti i tij i mbi rëndësinë e ogureve në kundërshtim kjo me dëshirën e tij. Këtu modeli i letërsisë antike i ka shtuar një dimension të ri tregimit: e tanishmja nuk është vetëm një përsëritje e të shkuarës por edhe një përmbushje e saj [17](#).

Mjedisi shqiptar

Çfarë mbetet nga shqiptarët në këtë kuadër romak? Pyetja është e vështirë për t'iu përgjigjur për shkak të mungesës së burimeve të tjera. Barleti veçanërisht thekson besueshmërinë e tyre, dhe dashurinë për liri, edhe pse ai i përshkruan patriotët e tij nga këndvështrimi i emigrantit, ai nuk e lejon veten të bëhet sentimental. Toni është mjaft tolerant: ata nuk janë mbrojtësit më të shquar të Kristianizmit. Në një situatë në të cilën ata shoqërojnë Skënderbeun dhe ushtrinë e tij me lutje të zjarra, ai shkruan: »Zoti kurrë më parë nuk kishte qënë kaq i pushtuar nga lutjet e popullit më luftarak sesa besimtar i Epirit!«

Një pasazh vecanerisht i gjallë është përshkrimi i Skënderbeut dhe ushtarëve të tij pas fitores së tyre të parë madhështore. Ushtarëve u ishte lejuar plaçkitje e pakufizuar në kampin turk (por jo përdhunim), dhe më pas ata shëtiten ngadalë të penguar nga gjërat e medha të plaçkitura duke ngjallur admirimin e njerëzve të cilët shikonin ushtrinë të kalonte. Udhëheqësit filluan të talleshin me ushtarët sepse ata ishin transformuar nga luftëtarë kurajozë në plackitës të thjeshtë bagëtish dhe nga mbrojtës të pavarësisë shqiptare në çobanë të zakonshëm. Ushtarët filluan të tallnin me radhë njëri-tjetrin. Ata imagjinonin sesi Ali Pasha dhe mbeturinat e ushtrisë së tij do të ishin inatosur nëse në njëfarë pike ata do të imagjinonin ushtrinë e mjerë nga e cila ishin pushtuar, njerëz jokompetentë dhe të përlulur, të përqëndruar vetëm në mbledhjen e presë së luftës.

»Në këtë mënyrë ushtarët ishin të gëzuar për ato që u takonin dhe lehtësonin marshimin duke u tallur derisa mbërritën në kampin e tyre, ku u rojet dolën përpara dhe përshëndesnin me britma të jashtëzakonshme.« Ilariteti dhe ngacmimi përçonin një atmosferë autentike. Pikërisht në një situatë të tillë shakaja është në vendin e duhur, meqë funksioni i saj është, midis të tjerash, të mënjanojë rrezikun pranë suksesit të papërmbajtur. Edhe individët vetë dhe e gjithë ushtria janë të tallur, madje nuk u kursyen as edhe synimet e mëdha të betejës, kuraja individuale dhe liria kombëtare. Duhet të jetë një mosrespektim karnavalesk gojor i vërtetë që e zbulon veten nëpërmjet formës latine [18](#).

Vetëm rrallëherë Barleti e hedh fjalën në faktin se bashkëatdhetarët e tij zotërojnë një poezi gojore. A do të ketë qenë e mundur kjo? Mbase po. Nëse e krahasojmë me autorët danezë të cilët kishin një qëllim të ngjashëm, atë të shpalljes së Danimarkës si një anëtar të vlefshëm të civilizimit evropian, është natyrale të tregojmë historinë e Saksos së Danimarkës nga c. 1200 në të cilin poezia gojore kombëtare i referohet si një paralel poezisë në Testamentin e Vjetër dhe Romës klasike. Ose mund të hidhemi në anën tjetër të Barletit dhe të përmendim përmbledhjet e baladave të Anders Soerensen Vedel nga viti 1591. Në parathënien e tij ai pretendon se në balada, danezët kanë një traditë poetike të vjetër, të gatshme për të konkurruar me trashëgiminë kulturore të vendeve të tjera. Barleti nuk përpiqet për diçka të ngjashme dhe kur i referohet shprehjeve të ndryshme të kulturës së tij, ai rregullisht e bën këtë me njëfarë rezerve. Për shembull, ai përmend një kontratë të krijuar gojarisht dhe vëren: »Do t'ia lë avokatëve të vlerësojnë vlefshmërinë ligjore të kësaj, nëse në ndonjë rast nuk do të preferojnë të pranojnë vendimin e luftës.« Në një pikë tjetër ai përshkruan një funeral tradicional. Vejusha fton, »sipas zakonit të popullit« shumë

gra të tjera për të vajtuar të vdekurin me kuje të cilat vazhdojnë pa ndërprerje ditë e natë. Ato radhisnin të gjithë virtytet dhe arritjet e të vdekurit dhe i referoheshin dhe stërgjyshërve të tij e pjesës tjetër të familjes. Por si shumë zakone të tjera, kjo traditë është zhdukur. Barleti nuk duket të ketë pritur nga audienca e tij që të respektonte cilësitë e traditave gojore të bashkëkombësve të tij [19](#).

Elemente të tillë në përshkrimin e jetës së Skënderbeut nga Barleti, meqë janë mbinatyrore janë trajtuar me skepticizëm ose kalimthi. Kështu ndodh për oguret që i paraprijnë lindjes së tij; por Barleti përmend me më shumë bindje që heroit ishte lindur me një shpatë të vizatuar në krahun e tij të djathtë. Këtu komenti i tij është se është e çuditshme se sa imtësisht natyra mund të informojë qeniet humane rreth planeve të saj. Autori, me sa duket, e kupton këtë si një informacion të një lloji tjetër nga ai i një ëndrre nëne apo diçkaje tjetër të ngjashme. Në Rilindje, një mendim i pranuar shkencërisht ishte se natyra kishte gjuhën e vet të koduar në të cilën u bënte të qartë njerëzve se çfarë vendi kishte çdo fenomen në sistemin e saj të përgjithshëm. Barleti gjithashtu rrëfen kalimthi se Mehmeti dhe Skënderbeu matnin forcat e tyre me një hark. Ky është një element epik, i njohur nga *Mahabharata*, *Ramayana* dhe *Odisea* dhe me një përhapje gjithashtu në përralla. Barleti mund ta ketë huazuar nga Homeri. Por duket më e mundshme se ai e ka marrë atë nga përrallat gojore rreth heroit mbi të cilin ndërton veprën e tij, meqë tek *Odisea* nuk është një konkurrim midis dy rivalëve, por midis pretendetëve të Penelopës nga njëra anë dhe Odisesë e Telemakut në anën tjetër; do të ishte një shmangie nga imitimi klasik i mundshëm jokarakteristik i mënyrës në të cilën Barleti zakonisht trajton modelet e tij. Kur në librin e 12-të Skënderbeu shkon në Romë për të bindur Papën të bëhet aleat, thuhet se ai udhëton i maskuar si një çoban i varfër. Më pas ky maskim nuk përmendet më. Përsëri kjo mund të kuptohet si një shenjë që Barleti di një version më mitik të udhëtimit të Skënderbeut sesa ai që na servir neve. Është e rëndësishme se sa rrallë përshkrimi i Barletit i për afrohet një përralle, duke patur parasysh se shumë nga informacioni që ai ishte në gjendje të merrte rreth heroit të tij duhet të ketë patur një formë më tepër apo më pak mitike. Me sa duket ai e konsideroi detyrë të vetën të racionalizonte historinë dhe të eleminonte çdo gjë që ai nuk e gjente të besueshme [20](#).

Barbarizmi dhe civilizimi

Barleti rregullisht i quan turqit »barbarë«, por jo »të pafe« siç edhe mund të pritej. Kjo të lë të kuptosh se beteja nuk është aq shumë midis besimit dhe mosbesimit sesa midis civilizimit dhe barbarizmit. Barbarët veçanërisht janë të karakterizuar nga egërsia dhe pabesia. Barleti lidh *perfidus* (të pabesë) me *barbarus* aq ngushtë sa që të dy fjalët bëhen pothuajse sinonime. Dinakëria e turqve demonstron që nga fillimi i veprës, kur Skënderbeu i ri është pro oborrit të sulltanit, por megjithatë ai gjatë gjithë kohës ndihet i kërcënuar me vdekje, deri kur në kontaktin e fundit që Skënderbeu ka me turqit ata i dërgojnë dhurata të shtrenjta me shpresën për ta tunduar që të heqë dorë nga lufta. Në përgjithësi barbarët shfrytëzojnë epërsinë e tyre ekonomike përmes korrupsionit. Për shembull kështu ata shtynë Moisiun dhe Hamzain në tradhti. E kundërta ndodh me Skënderbeun i cili thotë në fund të jetës së tij: »Unë kurrë nuk kam kryer apo kurdisur tradhti apo mashtrim«.

Barbarët janë edhe mizorë, Mehmeti më shumë se Murati. Përballë kësaj vendoset butësia e Skënderbeut, e cila, gjithsesi, duket më shpesh ndaj njerëzve të tij si Moisiu dhe Hamzai. Ndaj armikut, butësia e tij shfaqet në faktin se ai kurrë nuk kënaqet nga gjakderdhjet e panevojshme, edhe pse dora e tij nuk dridhet kur ai vret. Edhe egërsia e barbarëve përshkruhet në një mënyrë relativisht të zbutur. Fragmenti më i përgjakur është në librin e 8-të, e lidhet me atë sesi Mehmeti trajtonte të burgosurit e luftës. Dhe këtu tregimtari pothuajse dhe lë të nënkuptohet tallja, kur shpjegon se turqit mund të kenë

humbur kontrollin e tyre, sepse ata ishin të pamësuar të fitonin dhe kjo mbase sepse ata u ndien të provokuar nga fakti se shqiptarët dhe hungarezët e kanë të vështirë të shiten si skllavër, sepse nuk e pranojnë skllavërinë në heshtje. Mizoria nuk është aq shumë një element përbërës i barbarëve të Barletit sesa pabesia e tyre [21](#).

Shumë më shpesh besueshmëria është e lidhur me egërsinë dhe pabesia me civilizimin. Në lidhje me mashtrimin më të famshëm në letërsinë botërore, Kalin e Trojës, Virgjili ka bërë Laokontin të thotë: »I kam frikë grekët edhe kur ata sjellin dhurata.« Grekët e pabesë tepër të civilizuar vihen përballë trojanëve të thjeshtë e besnikë. Gjermanët e Tacidit krijojnë një paralel kritik me romakët e civilizuar dhe të degjeneruar të kohës së tij dhe tek Lucia ne gjejmë përshkrimet klasike të skithianëve të egër, të cilët e mbajnë fjalën e tyre deri në vdekje krahasuar me grekët e civilizuar e të pabesë si kundërshtarë të tyre.

Në një skenë nga rinia e Skënderbeut, turqit krahasohen edhe me popujt më barbarë, kur në fillim një skithian dhe më pas dy persianë mbërrijnë në oborrin e sulltanit dhe provokojnë luftëtarët e tij për në duel. Në të dy rastet Skënderbeu është ai i cili i lufton ata dhe fiton. Skithiani kërkon që ata duhet të jenë të zhveshur dhe të luftojnë me duart e tyre dhe komenti i tregimtarit është se ai u soll pothuajse si një kafshë e egër. Persianët, nga ana e tyre, janë shumë më tepër hileqarë se turqit: ata luftojnë dy kundër njërit dhe megjithëse ishte rënë dakord që Skënderbeu do të luftonte në fillim me njërin dhe nëse fitonte, me tjetrin, ai përfundon duke i mundur të dy në të njëjtën kohë. Në këtë mënyrë, karakteristikat tipike të turqve barbarë, egërsia dhe pabesia, krahasohen me raste edhe më ekstreme.

Një element që zakonisht është pjesë e përshkrimit të barbarëve, por të cilin Barleti nuk e përdor fare, është analfabetizmi. Turqit barbarë janë shkrimtarë letrash të zellshme po aq sa evropianët dhe ashtu si Skënderbeu në oborrin e sulltanit kishte patur jo vetëm një edukim heroik siç i kishte hije fisnikëve të egër, duke mësuar të kalëronte, të përdorte shigjetën dhe të thoshte të vërtetën, por edhe i ishin mësuar gjuhë, më vonë është thënë për Mehmetin se ai ishte në gjendje të lexonte greqisht, persisht dhe arabisht. Megjithatë barbarët nuk njohin latinishten, kështu që Skënderbeu nuk arriti të familjarizohej me klasikët grekë e latinë në oborrin barbar [22](#).

Krahasuar me turqit pastaj, Skënderbeu paraqitet po aq i civilizuar, por si krahasohet ai me të krishterët e tjerë? Kjo është tema e librit të 10-të, por që pyetja mund të ndërlikohet kur një komandant venedikas në librin 3 i flet ushtarëve të tij pak përpara një beteje me Skënderbeun. Në këtë fjalim venedikasi e quan atë një barbar meqë ai ishte edukuar nga turqit. Por në librin 10 heroi ynë ftohet në Itali si një aleat i Ferdinantit të Napolit dhe udhëtimi kthehet në një procesion triumfator të vërtetë. Në Raguzë, ku vendoset ushtria e tij, janë organizuar festivale dhe ecje sportive. E fjalime të sjellshme dhe elegante u bënë në nderim të shqiptarëve dhe raguzianëve së bashku. Kur Skënderbeu zbret në Bari, Zho i Anzhuinëve është aq i shokuar sa ai ngre rrethimin e qytetit, dhe mbreti Ferdinand vjen i shoqëruar nga i gjithë populli për të takuar Skënderbeun si çlirimtarin e vet. Përpara betejës vendimtare komandanti francez siguron ushtarët e vet se nuk ka asnjë arsye për t'u frikësuar nga Skënderbeu dhe ushtria e tij, edhe pse ata kanë korrur shumë fitore, ata kanë luftuar vetëm me turqit. Tani që ata do të takojnë burra të vërtetë gjërat do të jenë ndryshe. Prapëseprapë shqiptarët fituan dhe libri përfundon me festime në Napoli. Mbreti shpërndan një lëvdatë ekstreme për Skënderbeun, duke e quajtur atë babain e tij dhe duke i dhuruar tre qytete pulieze. Por vlerësimi më i lartë si një anëtar i plotë i civilizimit të krishterë i jepet Skënderbeut në librin 12 kur ai shkon në Romë për të kërkuar mbështetjen e Papës. Papa bashkë me kardinalët e tij nuk e pritën menjëherë me dashamirësinë më të madhe vetëm për shkak të famës së tij, por kur Skënderbeu mban një fjalim elegant në të cilin ai kryesisht i vlerëson ata në detaje dhe më pas thekson kërkesën e tij, ai menjëherë merr çdo gjë që kërkon [23](#)

Shkurtimisht: barbarët janë para së gjithash të pabesë dhe vetëm së dyti, mizorë, megjithatë, jo aq mizorë dhe dinakë sa skithasit dhe persianët. Skënderbeu është thelbi i besueshmërisë dhe butësisë, është po aq i edukuar sa çdokush tjetër në qendër të civilizimit të krishterë dhe shumë më tepër luftarak!

Koncepti i pazakontë i Barletit për barbarët bëhet i kuptueshëm kur shqyrtohen kundërshtarët e tyre: Skënderbeu dhe shqiptarët e tij. Për autorin nuk do të ishte i mundur një model që kundërvë një civilizim të butë, të edukuar, të arsimuar, por gjithashtu edhe dekadent e të pabesë, një shoqërie primitive të egër, të paedukuar, analfabete, kurajoze, dhe të besueshme. Do të ishte më e thjeshtë e kundërta. Por për Barletin është e rëndësishme të përshtasë kombin dhe kulturën e tij në botën e Europës Perëndimore dhe kryesisht Italisë gjë që ai e arrin duke përshkruar patriotët e vet si një kontrast mes civilizimit ndaj dhe barbarëve turq. Nga ana tjetër, portreti që ai jep për shqiptarët ka shume nuanca: Skënderbeu dhe disa nga ndjekësit e tij janë të mirëarsimuar dhe modestë, por shumë nga shqiptarët nuk janë të tillë. Në shumë raste Skënderbeu është i arsyeshëm kur oficerët e tij duan të luftojnë, dhe kur ndonjëherë ai i lejon ushtarët e tij të egërsohen, vepron kështu për të plotësuar dëshirat e tyre, si pjesë e maturisë së tij si komandant. Megjithatë në besueshmërinë dhe dashurinë për liri, ata janë të gjithë të barabartë. Kur në librin 1 Skënderbeu mbërrin në Shqipëri, atij nuk i duhet t'ia nisë duke ngritur një opozitë. Princërit e tjerë shqiptarë janë po aq të etur për luftë sa ai, por u mungon udhëheqësi. Dhe asnjë nga ushtarët e tij nuk ka dyshim se ata po luftojnë për liri.

Biografia heroike midis epikës dhe romanit

Periudha e luftrave midis shqiptarëve dhe turqve gjatë shekullit të 15-të mund të quhet një epokë tipike heroike në kuptimin çaduickian plot me ngjarje të dhunshme, të përshtatshme për poezi heroike gojore. Dhe Skënderbeu, në fakt, u bë temë në një traditë epike midis shqiptarëve që u vendosën në Pulia, ndërsa nuk duket të ketë patur një traditë të tillë pas vdekjes në Shqipëri, përkatësisht nën qeverisjen e Turqve. Sidoqoftë, kur në vitin 1832 J.G. von Hahn ishte duke kërkuar për traditat që lidheshin me të në rajonin e Krujës, rezultoi i pasuksesshëm. Për publikun lexues europian, megjithatë, fama e heroit u krijua me biografinë latine të Barletit. U bë më e shitura, u rishtyp shumë herë dhe gradualisht u përkthye në më të shumtën e gjuhëve të shkruara. Historia e tij u gjend në një bibliografi të hartuar nga G.T. Pérovitch më 1881 dhe është diskutuar nga J. Matl në një vepër nga viti 1968 ku ai del në përfundimin se një bashkëpunim i konsiderueshëm ndërdisiplinash do të ishte i domosdoshëm për të bërë një investigim të kujdesshëm të shumë fijeve që lidhin Barletin me letërsinë e mëvonshme europiane. Jo çdo gjë do të kënaqte Barletin e vjetër. Dramat mësimore që u krijuan rreth heroit të tij përputhen plotësisht me mesazhin didaktik të veprës së tij. Por atij me siguri që nuk do t'i vinte mirë me faktin që Skënderbeu u bë heroi i lirikave dhe romancave të dashurive sentimentale. Ai vetë besonte në atë që Skënderbeu të ishte shumë i disiplinuar në çështjet seksuale. Kur martohet Skënderbeu i Barletit, ai e bën këtë pothuajse i hutuar, me rekomandimin e miqve të tij dhe me ndërmjetës për t'u kujdesur për të gjitha praktikat, përfshirë kërkimin e një nuseje të përshtatshme, madje dhe në martesë ai është i përmbajtur me qëllim që të mos harxhojë energjitë e tij luftarake. As Petrovitch, as Matl nuk përmendin që Skënderbeu është një nga personat e përmendur nga autori danez Holberg's »*Heltes sammenlignede Historier efter Plutarchi Maade*« ('*histori krahasuese të heronjve në mënyrën e Plutarkut*'), 1739. Mënyra e përshkrimit të tij nga Holberg është në të gjithas qëllimet praktike besnike të Barletit, por biografi origjinal zor se do ta vlerësonte që heroi i tij ishte vendosur midis heronjve ekzotikë joeuropianë [24](#).

Me librin e tij Barleti hidhet nga prejardhja e tij kombëtare dhe format e krijimtarisë

gojoreshqiptare në kulturën qytetare italiane, të karakterizuar nga letërsia e shtypur dhe zbavitëse. Arsimimi i tij e kishte privuar nga krijimtaria në një traditë epike gojore. Përpjekjet e mësuara të autorëve për të përvetësuar gjinitë popullore i takojnë periudhave të mëvonshme. Por me lakminë e tij për të botuar material të vërtetë historik, nga i cili mund të mësonin lexuesit e tij, ai në fakt po punonte për të njëjtën arsye si epika gojore. Një epikë humaniste latine, përkundrazi, me sa duket, do t'i dukej atij shumë letrare dhe e papërshtatshme për një përshkrim aktesh heroike nga jeta reale pa përmendur çështjen nëse ai vetë kishte talent poetik. Të qënit një autor i madh proze nuk do të thotë domosdoshmërisht që ai ishte dhe një rimues i mirë. Forma më e përshtatshme për mesazhin e tij duhet të ishte kështu biografia. Në këtë formë ai mund të përqëndrohej mbi protagonistin dhe arritjet e tij dhe akoma të kembëngulë në vërtetësinë e tregimit. Historiografia, tamam siç është, p.sh. një përshkrim i qëndresës së shqiptarëve ndaj turqve, do të kishte qenë vetëm një histori e trishtuar. Duke e kufizuar kaq në mënyrë strikte kështu vetëm në përshkrimin e jetës së Skënderbeut, Barleti i kurseu vetes dhe lexuesve të tij rënien e Krujës, pushtimin e Durrësit dhe fitoren përfundimtare të turqve. Në të njëjtën kohë vepra e tij kishte një vlerë zbavitëse të krahasueshme me atë të epikës gojore dhe romanit borgjez. Me anë të protagonistit, autori formoi epokën heroike të popullit të tij në një mënyrë që mund t'i zotëronte lexuesit të cilët kishin një eksperiencë krejtësisht ndryshe. Tregimi i tij për Skënderbeun nuk është një roman i zhvilluar moralopsikologjikisht. Heroi i tij i ka të gjitha të drejtat cilësore nga fillimi dhe i mban ato të pandryshuara gjithandej. Por rruga e tij drejt pranueshmërisë së merituar nga autoritetet më të larta të botës është gjithashtu një lloj përparimi. Biografia e Barletit e vendos veten midis epikës dhe romanit në format e modelit të Lukasit, një fakt që aktualisht përkon shumë mirë me përpjekjet e autorit në vendosjen e urave lidhëse midis kulturës shqiptare dhe asaj Italiane rreth viteve 1500.

Shënime [Notes, in English]

Translation from English to Albanian thanks to Mrs. Almira Mucaj with kind assistance from Mrs. Ganimete Hoxha, who has edited the Albanian text, March 2007

HTML-PDF-edition by Bjoern Andersen. Version 1.3. - 16.03.2007. Comments to: webmaster@miqesia.dk.

1) The present article was originally written in Danish for Johan Fjord Jensen's *Festschrift: Fortælling og erfaring*, ed. by O.B. Andersen et al., Aarhus 1988, 135-58. I have not revised it or added to its bibliography. The analysis is based on Caspar Hedio's edition, Strasbourg 1538, to which quoted page numbers refer. Barleti's life and work have been carefully studied by Francesco Pall: "Marino Barlezio: Uno storico umanista" (*Mélanges d'histoire générale* 2, 1938, 135-318). I have also used P. Bartl s.vv. "Barletius" and "Scanderbeg" in *Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas*, hrsg. v. Mathias Bernath und Felix v. Schroeder, I-IV, Munich 1974. I have not had access to modern Albanian studies of Barleti. – I thank The Cultural Committee of Albania for a grant in 1974, when I first read Barleti, Herzog August Bibliothek in Wolfenbüttel, where I had excellent study facilities in 1987-88, Bjoern Andersen of the Albanian-Danish friendship association *Miqësia*, who invited me to translate the article and undertook its electronic publication, and John D. Kendal for revising my English.

2) Shkodra: p. 103. Scanderbeg and Murad's thoughts: pp. 137-9. *Nostris*: p. 18. Wonderful sight: p. 124. Moses: p. 128. Fear or danger: p. 123. Barbarian: p. 72. Burden: pp. 2 and 194-5.

3) Oblivion: p. 59. Venice: pp. 36, 41, 160, 368. Alfonso: p. 279. Pius: p. 332. Paul: pp. 355-6.

- 4) An "inventory" of a heroic life has been compiled by Jan de Vries: *Heldenlied und Heldensage*, übersetzt vom Verfasser, Bern, Munich 1961 (*Sammlung Dalp* 78).
- 5) History: pp. 36-7. Pompeius Trogus 42.3.4. Aeneas Silvius: *Descriptio Europae* 15 (Hedio's edition of Barleti p. vi.r). Virgil: *Aeneid* 7.655-69 and 8.185-275. Danish-Swedish polemics over history: Karen Skovgaard-Petersen: "Margaretica: Et bidrag til den dansk-svenske pennefejde i det 16. århundrede" (*Historisk Tidsskrift* 87, 1987, 209-36). Cf. Lars Boje Mortensen on Saxo's similar opinion of the place of the Danish people in world history: "Saxo Grammaticus' view of the origin of the Danes and his historiographical models" (*Cahiers de l'Institut du Moyen-Age grec et latin* 55, 1987, 169-83.)
- 6) Tempo: p. 359. Bow contest: p. 198. Amesa corrected: p. 91. Quotations: pp. 65-70.
- 7) Hardly any: p. 230. Polemic: pp. 70-71. Pall (cf. note 1) pp. 177-86. Neapolitan historians: p. 285.
- 8) Interested reader: p. 261. Tongue in cheek: p. 25; the phrase is taken from Livy 2.10.11.
- 9) Biography and individualism: Jacob Burckhardt: *Die Kultur der Renaissance in Italien, ein Versuch*, hrsg.v. Werner Kaegi (1859), Stuttgart, Berlin, Leipzig 1930, 236-46. Agnes Heller: *Der Mensch der Renaissance*, übers.v. H.-H. Paetzke, Köln-Lövenich 1982, 220-78. – Plutarch: Marianne Pade: "Danske ligtaler i det 16. århundrede" (Marianne Alenius & Peter Zeeberg (eds.): *Litteratur og lærdom*, Copenhagen 1987, 95-106) 97. – Biography in the Middle Ages and the Renaissance: Jozef IJsewijn: "Die humanistische Biographie" (*Wolfenbütteler Abhandlungen zur Renaissanceforschung* 4, 1983, 1-19) 9-14. – Scruples: pp. 13-14.
- 10) Two types: Marianne Pade: "Alfonso I's triumf i Napoli, brugen af antikken i det repræsentative sprog" (*Museum Tusulanum* 57, 1987, 203-21).
- 11) Meeting in Lezha: p. 36. Soldiers: p. 316. Ambassadors: p. 199. Ploughshare: p. 334. – *Mitis, facilis*: p. 11, *fortuna, virtus, prudentia*: p. 24, *patientia, corporis robur, indefatigabilis vigor animi*: p. 25, *cautus princeps*: p. 54, *veteranus dux*: p. 133, *divina verius quam humana clementia*: s. 251. Pade (cf. note 1). Burckhardt (cf. note 9), 239.
- 12) Dubious clemency: p. 21. *Pius* or *callidus*: p. 85. Criticism: p. 91. Amesa's error: p. 99. Praise of Daynium: pp. 99-100.
- 13) Historicity: Pall (cf. note 1), 199-228. Josef Matl: "Georgius Castriota (Kastriot) Scanderbeg in der belkanischen und europäischen Literatur" (*Bulgarische Jahrbücher* 1, 1968, 101-10) 105. Bartl (cf. note 1). Armin Hohlweg: "Der Kreuzzug des Jahres 1444: Versuch einer christlichen Allianz zur Vertreibung der Türken aus Europa" (*Die Türkei in Europa*, hrsg.v. K.-D. Grothusen, Göttingen 1979, 20-37) 29. – Machiavelli: Martin Raether: "In ogni fortuna principe, Der Fürst als Persönlichkeitsideal des Dichters Machiavelli" (*Wolfenbütteler Renaissance Mitteilungen* 11, 1987, 101-17).
- 14) IJsewijn (cf. note 9) 4-5.
- 15) Turkish letters: Franz Babinger: *Laudivius Zacchia, Erdichter der "Epistolae Magni Turci" (Neapel 1473 u.ö.)*, Munich 1960 (*Bayerische Akademie der Wissenschaften, Phil.-hist. Kl.* 1960, 13) 38. – Marcelli: p. 135. Perlatus' speech: pp. 140-44. Epilogue: p. 147. *Elaborata barbari oratione*: p. 28. Papius: p. 25. Fabius: p. 34.
- 16) Pall (cf. note 1) 278-97.
- 17) Gunpowder: pp. 131 and 198. Tydeus: p. 334. Amesa: pp. 265-70. Lucan: *Pharsalia* 7, 161-63, 539-44, 853-4.
- 18) *Numquam ab Epirotica bellicosiori magis, quam religiosiori populo tot precibus Deus fatigatus*: p. 91. *loci cantusque*: pp. 54-5.
- 19) Saxo: Karsten Friis-Jensen: *Saxo Grammaticus as Latin Poet: Studies in the Verse Passages of the Gesta Danorum*, Rome 1987. (*Analecta Romana Inatituti Danici* Suppl. 14.) – Contract: p. 77. Funeral: 239-40.
- 20) Omens: p. 5. Bow contest: p. 198. Disguise: p. 355.
- 21) *Nihil umquam fraudis, nihil doli aut feci, aut machinatus sum*: p. 367. Mehmed: pp. 240-41. Bloodier descriptions are related by Ernst Werner: *Die Geburt einer Grossmacht – Die Osmanen (1300-1481): Ein*

Beitrag zur Genesis des türkischen Feudalismus, 3. Aufl., Berlin 1978, 284.

22) *Aeneid* 2.49. Lucian: Especially the dialogue *Toxaris or Friendship*. Of Herodotus and the barbarians, see Francois Hartog: *Le miroir d'Hérodote: Essai sur la représentation de l'autre*, Paris 1980. – Duels: pp. 8-9. Mehmed's knowledge of languages: p. 197.

23) Venetian: p. 79. Frenchman: p. 298. Scanderbeg and the pope: pp. 355-8.

24) H.M. Chadwick: *The Heroic Age*, 2. ed., Cambridge 1926. – Georges T. Pérovitsch: *Scanderbeg (Georges Castriota): Essai de bibliographie raisonnée*, Paris 1881. – Matl (cf. note 13), information of von Hahn: 105. – Scanderbeg's marriage: pp. 199 and 252.
